



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 438/4 Prot.

Tiranë, më 14.11.2018

### VENDIM

Nr.91, datë 14.11.2018

**“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 1417/9, datë 13.04.2018, të njësisë përgjegjëse, pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, për lirim nga shërbimi civil të punonjësit \*\*\*\*\*, për shkak ristrukturimi.”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit \*\*\*\*\*,

### VËREJ SE

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 438 prot., datë 10.05.2018, punonjësi \*\*\*\*\* ka ngritur pretendimin se nuk është zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, gjatë procedurës së liritimit nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, për shkak të suprimimit të pozicionit të tij të punës.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, në lidhje me këtë rast, rezulton se, punonjësi \*\*\*\*\* ka punuar pranë Prefekturës së Qarkut Lezhë, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm” që prej vitit 2000 (sipas urdhrorit të emërimit

nr. 80, dt. 01.11.2000). Statusin e nëpunësit civil e ka përfiturar në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ç`ka provohet me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit nr. 2926/3 prot., dt. 14.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike.

Nisur nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me ristrukturimin e institucionit, konstatohet se, pas miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit për vitin 2016, bazuar në urdhrin nr. 13, datë 12.01.2016, të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës në Prefekturën e Qarkut Lezhë”*, njësia e *“Sektorit të Auditit të Brendshëm”*, e cila parashikohej në strukturën e mëparshme, në strukturën aktuale nuk ekzistonte më. Komisioni i ristrukturimit, i ngritur pranë këtij institucioni me këtë rast, ka arritur në përfundimin e pamundësisë së sistemimit të punonjësit \*\*\*\*\* në ndonjë pozicion të lirë pune, për të cilin ai të plotësonte kërkesat e veçanta, e në këto rrethana, me urdhrin nr. 32, datë 24.04.2016, të Prefektit të Qarkut Lezhë, ai është liruar nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

Nga analiza e mëtejshme e akteve të administruara për shqyrtimin e këtij rasti, rezulton se, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në planin vjetor të punës, nëpërmjet Vendimit nr. 139, datë 30.12.2015 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil”*, ka vendosur të përfshijë në procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme institucionin e Ministrisë të Punëve të Brendshme si dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil, ndër të cilat edhe institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë.

Në përfundim të mbikëqyrjes, me Vendimin paralajmërues nr. 155, datë 12.12.2016, për rregullimin e ligjshmërisë, Komisioneri, ndër të tjera ka kërkuar nga njësia përgjegjëse edhe revokimin e aktit nr. 32, datë 20.04.2016, *“Për lirimin nga shërbimi civil”*, për nëpunësin \*\*\*\*\* dhe dërgimin për rishqyrtim të këtij rasti në Komisionin e Ristrukturimit, për të parë edhe një herë, mundësinë e sistemimit të tij në ndonjë nga pozicionet e lira ekzistuese, duke nënvizuar që në të gjitha rastet, vendimi i komisionit të ristrukturimit, duhet të jetë i arsyetuar dhe i argumentuar ligjërisht.

Nga ana tjetër, rezulton se punonjësi \*\*\*\*\* ka paraqitur edhe padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 32, datë 20.04.2016, *“Për lirimin nga Shërbimi civil”*, e cila me Vendimin e formës së prerë nr. 374(454), datë 01.06.2017 ka vendosur, *“Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, detyrimin e palës së paditur Prefekti i Qarkut Lezhë, për ti paguar palës paditëse \*\*\*\*\* pagën që ka përfiturar në momentin e largimit nga shërbimi civil, nga dita e largimit dhe në vazhdim deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit të këtij institucioni”*.

Në këto kushte, bazuar në urdhërimet e dispozitivit të vendimit nr. 155, datë 12.12.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Prefekti i Qarkut Lezhë me

urdhrrin nr. 12, datë 17.03.2017, ka anuluar urdhrin nr. 32, datë 20.04.2016, “Për lirimin nga Shërbimi civil”, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm”, duke urdhëruar në të njëjtën kohë, pagesën e pagës për periudhën nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, deri në daljen e vendimit të rishikuar të Komisionit të Ristrukturimit.

Vërtetohet se, Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, në zbatim të akteve të sipërpërmendura, e ka paguar nëpunësin \*\*\*\*\*, duke filluar nga data **01.08.2016**, deri në datën **18.04.2018**, me pagën e plotë që duhet të përfitonte ky punonjës, në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm”, në kushtet e pamundësisë së rikthimit në detyrë, për shkak se në strukturën e re, i ishte suprimuar pozicioni i punës. (Ky fakt vërtetohet nëpërmjet shkresës nr. 1171 prot., dt.03.09.2018, të Prefektit të Qarkut Lezhë, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil).

Në këtë rast, vlerësojmë se periudha e mësipërme, për efekt të vjetërsisë në punë, barazohet me qenien në një marrëdhënie të rregullt pune, prandaj kjo periudhë duhet të llogaritet si e tillë dhe duhet të shënohet në regjistrin e personelit, si vjetërsi në punë dhe në shërbimin civil.

Për të realizuar këtë të drejtë, për nëpunësin \*\*\*\*\*, duhet të kryhen plotësimet e nevojshme në aktin e liritimit nga shërbimi civil nr. 1417/9, dt. 13.04.2018, duke përmendur në mënyrë të shprehur njohjen e kësaj periudhe si vjetërsi në punë dhe në shërbimin civil, dhe rillogaritjen e shpërblimit sipas pikës 7/c, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (pasi pas rillogaritjes, vjetërsia në shërbimin civil e nëpunësit \*\*\*\*\*, është përfshirë në kategorinë 3 – 6 vjet).

Rezulton se, Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin e tij nr. 123/1, dt. 15.12.2017, ka urdhëruar ringritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili do të vepronte në përputhje me bazën ligjore që rregullon institutin e ristrukturimit të institucionit.

Në vijim të procesit, Komisioni i ristrukturimit, i ngritur si më sipër, në kushtet kur pozicioni i mëparshëm i punës së nëpunësit \*\*\*\*\* “Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm”, me strukturën e re ishte suprimuar, ka rishikuar edhe një herë mundësinë për sistemimin e tij në ndonjë pozicion tjetër të lirë në institucion, ose në ndonjë institucion tjetër, për të cilin ai plotësonte kërkesat e posaçme.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit, me vendimin e tij nr. 1417/6, datë 28.03.2018 “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit për punonjësin \*\*\*\*\*”, ka arritur në konkluzionin se, sistemimi i tij ishte i pamundur, pasi nuk kishte ndonjë pozicion të lirë pune për të cilin ai të plotësonte kërkesat e veçanta, sipas kualifikimit arsimor që zotëronte. Është konstatuar se, për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor, ka qenë i pamundur sistemimi i tij edhe në tre

pozicione të tjera të lira në institucion (*dy pozicione, specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe një pozicion specialist në Sektorin Juridik*). Po ashtu, për të njëjtat arsye, nuk është gjetur mundësia e sistemimit të tij në institucione të tjera të shërbimit civil (*me distancë më pak se 45 km, nga vendbanimi i nëpunësit*) sipas listës së pozicioneve vakante dhe përshkrimeve të tyre të punës, të vëna në dispozicion nga DAP.

Nisur nga gjithë sa sipër, Komisioni i Ristrukturimit ka vendosur të propozojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës, duke i njohur atij të drejtën e përcaktuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, ku parashikohet e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, me pagën e 3 muajve dhe e drejta që për një afat dy vjeçar, të ketë mundësi të konkurrojë me lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, në pozicione pune për të cilat ai përmbush kërkesat ligjore.

Njësia e burimeve njerëzore e Prefektit të Qarkut Lezhë, ka nxjerrë aktin mbi bazën e vendimit nr. 1417/9, dt. 13.04.2018, të Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe asaj financiare, për nëpunësin \*\*\*\*\*, në **dt. 20.04.2018**.

Në vlerësim të rrethanave si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se ky akt, si në thelbin e tij, në kuptim të urdhërimit të ndërprerjes së marrëdhënieve në shërbimin civil për nëpunësin \*\*\*\*\*, për shkak të pamundësisë së sistemimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, ashtu dhe në drejtim të respektimit të rregullave të përcaktuara për kryerjen e procesit të ristrukturimit, është i drejtë.

Por, nga ana tjetër, Komisioneri arrin në konkluzionin se, ky akt ka nevojë të plotësohet në ato drejtime që u analizuan në pjesën e sipërme të këtij vendimi, që kanë të bëjnë me vjetërsinë në shërbimin civil si dhe masën e dëmshpërblimit, në mënyrë që të respektohet i gjithë spektri i të drejtave të nëpunësit civil, të cilat parashikohen nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

Konkretisht, akti nr. 1417/9 dt. 13.04.2018, i Prefektit të Qarkut Lezhë, duhet të plotësohet në drejtim të urdhërimit për njohjen si vjetërsi në punë dhe në shërbimin civil, për të gjithë periudhën që ka zgatur procesi i ristrukturimit dhe pas kësaj, rillogaritjen e dëmshpërblimit sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

Po kështu, në aktin e mësipërm duhet të shënohet në mënyrë të shprehur edhe e drejta e parashikuar në pikën 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, sipas të cilës, nëpunësi, brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare, ka të drejtë

konkurrojë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, për pozicione të të njëjtës kategori dhe ngritjes në detyrë, për pozicione të lira, në një kategori më të lartë.

Në këto rrethana, Komisioneri arrin në përfundimin se akti nr. 1417/9, dt. 13.04.2018, i Prefektit të Qarkut Lezhë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për nëpunësin \*\*\*\*\*, për shkak të pamundësisë së sistemimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, në përfundim të procesit të ristrukturimit, është i mbështetur në ligj, por ai ka nevojë të plotësohet në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ashtu si u analizua më sipër.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, të drejtojë procesin për të realizuar detyrat e lëna për plotësimin e aktit administrativ nr. 1417/9, dt. 13.04.2018, të Prefektit të Qarkut Lezhë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për nëpunësin \*\*\*\*\*, si më poshtë:
  - Pas pikës 2, të shtohet pika 2.a, me këtë përmbajtje: Periudha prej datës **01.08.2016**, deri në datën **18.04.2018**, të njihet si vjetërsi në punë dhe vjetërsi në shërbimin civil, si dhe të bëhen shënimet përkatëse në regjistrin e personelit.
  - Pas pikës 2.a, të shtohet pika 2.b, me këtë përmbajtje: Nëpunësi civil \*\*\*\*\*, brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil, ka të drejtë konkurrojë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, për pozicione të të njëjtës kategori dhe ngritjes në detyrë, për pozicione të lira, në një kategori më të lartë.
  - Pika 3, të ndryshohet si vijon: Të paguhen 6 paga mujore dëmshpërblim në favor të punonjësit në fjalë. (në këtë rast, gjatë ekzekutimit të shumës së dëmshpërblimit financiar, duhet të verifikohet nëse punonjësi ka përfituar më parë dëmshpërblim dhe nëse po, atëherë shuma e përfituar duhet tëzbritet nga vlera përfundimtare).

2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrat e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim, Prefektura e Qarkut Lezhë, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**